

Përshëndetje për të gjithë!

I nderuar rektor z. Bajram Kosumi, të nderuar staf akademik, staf administrativ dhe ju studentë,

Rugëtimim tim katërvjecar të studimeve në fushën e drejtësisë gati se po i vie fundi. Gjatë këtij cikli të studimeve ka qenë përpjeke e imja e vazhdueshme që studimet t'i kem në plan të parë, kam bërë studim sistematik dhe të mirëfilltë. Të studiuarit e fakultetit juridik ka qenë gjithmonë ëndërr e imja. Ëndrrat nuk bëhen realitet vetëm sepse ti ëndërron për to. Është puna e vazhdueshme ajo që realizon gjithçka, andaj jam e lumtur që në këtë universitet me vullnet dhe punë kam përvetësuar konceptet kryesore të drejtësisë në mënyrën më të mirë. Kam ndërtuar një bazament të fortë të njohurive në fushën ku studioj. Dhe këtë e kam arritur me mesim logjik, studim sistematik dhe se gjithmonë kam qenë kërkuese ndaj profesorëve për çdo pyetje apo çështje të paqartë. Përvojat e fituara këtu kanë ndikuar në formësimin tim si njeri dhe në aspektin profesional. Andaj, sot, kur pranoj një mirënjohje të tillë është një ndjenjë e vecantë, ngase më jep epitelin "*studente e dalluar*" me notën 10. Padyshim se këte mirënjohje ua dedikoj familjes time dhe te gjithë atyre që ishin bashke me mua në këtë rrugëtim e që me mbështetjen e tyre besuan në mua.

Së fundi, shfrytëzoj rastin të i uroj Universitetit "Kadri Zeka" 8 vjetorin e themelimit. Uroj që dyert e ketij universiteti, ashtu si po nxjerrin kuadro kualitativë te studentëve, te ju ofrojnë mundësinë nesër që po këta studentë të dalluar të kthehen përsëri në Universitet si kolegë të juaj në botën akdemike dhe bashkëudhëtarë në dhënien e kontributit në arsimimin dhe ngritjen akademike e profesionale te gjeneratave të reja të studentëve në universitetin tonë. Edhe një herë, Urime ky pervjetor dhe ju prifte e mbara dhe suksese te gjithëve.

FALEMINDERIT!